

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA SKUPSTINA OPSTINA SUVA REKA	
	17.07.2024 	

Datë: 17.07.2024

Në bazë të vendimit 01-Nr.016-18863 të dates 28.03.2024 të Asamblesë Komunale, në bazë të vendimit të Asamblesë Komunale për formimin e komisionit 01-Nr.016-24238 të datës 29.04.2024, në bazë të procesverbaleve të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të dates 05.07.2024 datë 09.07.2024 dhe datë 17.07.2024, në bazë të nenit 15 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës se paluajtshme të Komunës ligji Nr.06/L-092, komisioni përkatës vendosi njëzëri të shpall këtë:

KONKURIM TË HAPUR

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme komunale:

1. Parcelat Kadastrale:

P-72116046-01211-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej: 2943 m², sipas certificates se pronës nr.1003/2024 datës 12.03.2024, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur POJATA, e evidentuar në emër të Komunës së Suharekës.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lartë ndahen 688 m², për ndërtim të objektit afarist banesorë, me destinim ZShP4 (Zonë për shfrytëzim të përzier) sipas Hartës Zonale të Komunës së Suharekës .

Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit për personat fizik dhe juridik.
2. Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik).
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik – Tatimi në prone; për personat juridik – Taksa komunale dhe tatimi në pronë.
4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (për personat juridik0.
5. Deklaratë vjetore tatimore nga ATK-ja (Forumlar vjetor tatimorë për dy vitet e fundit)-për personat juridik.
6. Garancioni banker nga banka ose kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë në 10% të vlerës së investimeve i cili duhet të sillet para nënshkrimit të kontratës.



Kriteret e kërkuara;

- Oferta ekonomikisht më e favorshme.**10% të pikëve.**
- Dëshmi për mundësi të realizimit të projektit si: qarkullimi banker për dy vitet e fundit, marrëveshje me ndonjërin nga bankat komerciale në Kosovë, apo marrëveshje të noterizuar (konsorcium) me operatorë ekonomik – **10% të pikëve.**
- Poseduesi i njësisë kadastrale në bazë të të drejtave të tij pronësore-juridike i takojnë jo më pak se 20% e ndërtimit NETO (Banesa dhe lokale afariste - të cilat duhet ti paraqes në bazë të përqindjes (%) në secilën etazh të ndërtimit) – **60% të pikëve.**
- Plani Dinamik.....**20% të pikëve.**

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- Aplikimi nën normat minimale të definuara do të thotë diskualifikim.
- Veprimtaria jo adekuate do të thotë diskualifikohet nga konkurimi.
- Kushtet dhe Leja Ndërtimore për parcelat në fjalë definohen për komplet bllokun ndërtimor.
- Kushtet ndërtimore dhe Leja ndërtimore definohet nga Drejtoria për Urbanizem, Planifikim dhe Mjedis konform Hartës Zonale të Komunës së Suharekës dhe dispozitat e tjera ligjore.
- Kushtet themelore janë:
 - Destinimi: Sipërfaqe Urbane e Përgjithshme,
 - Etazhiteti – 5 etazhe mbi nivelin e tokës.
 - Indeksi i shfrytëzimit të shputës së ndërtimit-min. 30-50%.

(Për informata më të hollësishme rreth kushteve të ndërtimit, drejtoheni pranë DUPM-së

- Gjate procesit të paisjes me leje duhet ti paraqes sipërfaqet e banimit dhe afarizmit të cilat do t'i kompenzohen Komunës së Suharekës.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është nga dita e publikimit deri me date 27.07.2024, zyra pritëse të gjendja civile, Komuna Suharekë.

Afati dorëzimit të ofertave me datë 02.08.2024 deri në ora 13:30 zyra pritëse te gjendja civile Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet me 02.08.2024 në ora 14:00 në sallën e bordit në Komunën e Suharekës. Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i kuvendit komunal të Komunës së Suharekës dhe përfituesin e vendos Asambleja Komunale konform ligjit nr.06/L-092.

Informatat shtesë:

Nr.tel: 029/271-318 dhe 049/112-211

visar.kuqi@rks-gov.net



Kryesuesi i komisionit:

Visar KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Numri i protokollit:

-Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të datës 31.07.2013, si dhe Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative, duke u mbështetur në Hartë Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis në Suharekë lëshon këtë:

NJOFTIM

(Përshkrimi i destinimit të parcelës kadastrale)

Ky dokument lëshohet për nevojat e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Përshkrimi:

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis konstaton se parcelat 01211-0 ZK Suharekës sa i përket destinimit të saj të paraparë me Hartë Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030.

Është në kuadër të Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 është me destinim Zonë për shfrytëzim të përzier –ZSHP-4.



Vërejtje:

Lëshimi i këtij dokumenti nuk nënkupton lejimin e ndryshimit të destinimit të gjendjes në teren nga ajo e paraparë me Hartë Zonale të Komunës.

Njoftimi i dërgohet: Dosjes së DUPM-së

Drejtor i Drejtorisë:
Visar KUÇI

